Shoqeria * BAMI *shpk ka mbi 8 vjet aktivitet.Ne çdo fund te vitit ka hartuar bilancet dhe dhenien e llogarise ku dy vitet e fundit sipas informacioneve dhe dokumentave qe disponojme eshte bere dhe auditimi i llogarise vjetore nga shoqeria e Auditimit *Studio ELB* shpk.Audituesit kane çertifikuar pozitivisht bilancet duke shprehur dhe metoden e vleresimit te aktiveve dhe detyrimeve te shoqerise perkatesisht per llogarite vjetore 2004-2005.Ne pasqyren e meposhteme eshte paraqitur bilanci i dy viteve te fundit per shoqerine qe eshte ne ndryshim e siper te Kapitalit Themeltar :

**_Shoqeria * BAMI *shpk,Kruje._**
**_Kapitali I Themelimit 100 000 leke._**
**_Administrator Besnik BAMI._**

| ***Aktivi*** | **31 Dhjetor 2005** | **31 Dhjetor 2004** |
|---|---|---|
| Aktive te Qendrueshme | | |
| te patrupezuara | 0.00 | 0.00 |
| te trupezuara | 26,898,487.00 | 20,020,623.00 |
| financiare | 0.00 | 0.00 |
| amortizim akumuluar | (13,101,228.00) | (10,580,495.00) |
| Totali Aktiveve te Qendrueshme | 13,797,259.00 | 9,440,128.00 |
| Aktive Qarkulluese | | |
| Inventare | 5,267,063.00 | 3,269,611.00 |
| Kliente per sherbime | 14,674,089.00 | 0.00 |
| Ortak Kapital I paderdhur | 0.00 | 0.00 |
| Personeli dhe persona | 0.00 | 0.00 |
| Te tjera kerkesa | 0.00 | 0.00 |
| Provizione | 0.00 | 0.00 |
| Llogari rrjedhese ne Banke | 69,572.00 | 8,610.00 |
| Arka | 123,400.00 | 258,319.00 |
| Vlera te tjera arke | 0.00 | 0.00 |
| Totali i Aktiveve Qarkulluese | 20,134,124.00 | 3,536,540.00 |
| Difernca konvertimi aktive | 0.00 | 0.00 |
| Shpenzime per tu shperndare | 0.00 | 0.00 |
| ***Totali i Aktiveve*** | **33,931,383.00** | **12,976,668.00** |
| ***Pasivi*** | | |
| Kapitalet e veta | | |
| Kapitali i nenshkruar | 100,000.00 | 100,000.00 |
| Prime te lidhura me kapitalin | 0.00 | 0.00 |
| Diferenca rivleresimi | 0.00 | 0.00 |
| Rezervat | 135,824.00 | 135,824.00 |
| Fitime/Humbje te mbartura | 2,671,761.00 | 1,620,714.00 |
| Fitime dhe Humbje | 2,244,453.00 | 1,051,047.00 |
| Totali i Kapitaleve te veta | 5,152,038.00 | 2,907,585.00 |
| Provizione | 0.00 | 0.00 |
| Detyrime te kerkueshme | | |
| Huara nga bankat | 7,983,846.00 | 0.00 |
| Huara te tjera | 0.00 | 0.00 |
| Shuma te arketura per porosi | 0.00 | 0.00 |
| Furnitore per sherbime | 8,746,420.00 | 0.00 |
| Personeli & Sigurime shoqerore | 104,900.00 | 56,885.00 |
| Ortake | 10,471,584.23 | 9,780,000.00 |
| Shteti Tatim Taksa | 1,472,594.77 | 232,198.00 |
| Te tjera detyrime | 0.00 | 0.00 |
| Totali i Detyrimeve | 28,779,345.00 | 10,069,083.00 |
| Diferenca Konvertimi pasive | 0.00 | 0.00 |
| ***Totali i Pasiveve*** | **33,931,383.00** | **12,976,668.00** |



*Halim BAKALLI.*
*Ekspert Kontabel I Autorizuar.*
*Liçensë nr.103.*

## V.Vleresimi i zmadhimit te kapitalit dhe veprimet ne kontabilitet si rezultat i ngjarjes ekonomike.

Mbi bazen e Bilancit vjetor 2005 dhe verifikimeve te bera rezulton se ne momentin e krijimit nga ana e Ortakut te vetem jane sjelle ne forme kontributi ne shoqeri asete fikse.Me hyrjen e tyre ne shoqeri nga ana e Ortakut te vetem nuk eshte marre vendim per ti konfirmuar si kontribut ne kapital por jane lene si detyrim i shoqerise ndaj Ortakut te vetem.

Struktura e Aseteve fikse te kontribuara qe jane ne kontabilitet te shoqerise me vlere 15 523 622 leke paraqitet si meposhte:

- Makineri e Pajisje 3 543 622 leke
- Mjete Transporti 11 980 000 leke

Gjate aktivitetit te saj shoqeria ka realizuar fitime neto te cilat nuk i ka shperndare ne forme dividenti por paraqiten ne pasiv te bilancit tek grupi i kapitaleve te veta ne shumen leke 5 052 038 e ndare ne fitime per 4 916 214 leke dhe ne rezerva 135 824 leke.

Si rezultat i ketyre fitimeve shoqeria ka realizuar mjete te lira monetare per pakesimin e detyrimit ndaj ortakut,duke e pakesuar ne masen 5 052 038 leke.Detyrimi ne fund te bilancit 2005 ndaj ortakut paraqitet ne vleren 10 471 584 leke.

Ortaku i vetem ka vendosur te mos e kerkoje kete detyrim qe i ka shoqeria, por ta kaloje ate ne zmadhim kapitali ne formen e kontributit ne natyre me te njejten vlere te aseteve fikse te sjella ne momentin e krijimit te shoqerise pakesuar me vleren e fitimit si detyrim i kthyer.

Ne te njejten kohe Fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara jane vendosur te kalojne ne zmadhim kapitali.Vlera e fitimeve dhe e Rezervave eshte 5 052 038 leke.

Si rezultat i ketij vendimi me nr.1 date 29.05.2006 te Ortakut te vetem lindin pakesime detyrimesh e shtim te kapitaleve te vertetuara e te vleresuara nga ana e jone.Ne kontabilitet te shoqerise do te behen keto veprime si rezultat i kesaj ngjarje ekonomike:

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Debitohen | Llogarite | 105 *Rezerva Ligjore * | 135 824 | leke |
| Debitohen | Llogarite | 107 *Fitime te mbartura * | 2 671 761 | leke |
| Debitohen | Llogarite | 121 *Fitime ushtrimi 2005 * | 2 244 453 | leke |
| Debitohen | Llogarite | 456 *Ortak veprime me Kapitalin * | 10 447 962 | leke |
| Kreditohet | Llogaria | 101 *Kapitali i Nenshkruar* | 15 500 000 | leke |

## VI.Grupi I Kapitaleve te veta.

Struktura e grupit te kapitaleve te veta pas ketyre ndryshimeve I reformuar paraqitet si me poshte:

Perfundimisht mbi bazen e analizave te mesiperme, nisur dhe nga fakti se shoqeria ka nje Ortak te vetem,opinioni jone per ndryshimin e mases se kapitalit te nenshkruar eshte i pranueshem ,I bazuar ne ligj dhe ploteson e kerkesat e neneve 61,62 e 63 te ligjit nr.7638 date 19.11.1992* Per Shoqerite Tregetare *,i ndryshuar.

*Halim BAKALLI*

*Ekspert Kontabel I Autorizuar*
*Liç.103.*

***Raport per :***

*Ortakun e vetem z.Besnik BAMI.*

*Shoqerine * B A M I * shpk.Kruje.*

Tirane,me 26.Qershor.2006.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**NOTERIA** Tirane.
**Nr.** 1827 **Kol**
**Nr.** — **Rep**

**V E R T E T I M**

diten e merkure ,me 28.06. 2006(dymijeegjashte),ne ____________,para meje noterit Elmira Kodra ,anetar I Dhomes se Notereve Tirane ,u paraqit Eksperti Kontabel i Autorizuar :
z.Halim BAKALLI , i biri I Qazimit dhe Mamudies, i datelindjes 20 Tetor 1962,lindur ne Kukes dhe banues ne adresen : Rruga *DON BOSCO*,Pallatet *HAWAI*kulla nr.5, ap1/1, Tirane,me pasaport Nr.Z1029107 ,shtetas shqiptar,madhor dhe me zotesi Juridike per te vepruar,i panjohur me pare personalisht prej meje,per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te dokumentit identifikues qe me paraqiti, i cili me deklaroi se jashte kesaj zyre ka formuluar kete Raport per zmadhimin e kapitalit drejtuar Shoqerise * B A M I *shpk te cilin ia lexoj dhe e nenshkruan ate rregullisht para meje.Une, noteri, konform ligjit e vertetoj ate.

**NOTERI**



NOTERE
ELMIRA KODRA
RR. DURRESIT TIRANE
Tel ... 238129

# INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR TE SHQIPERISE
## (IEKA)



# LICENSE

*Kjo license i leshohet,* Z. HALIM Q[illegible] BAKALLI

*per te ushtruar profesionin e* **EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR.**

*Kjo License leshohet ne baze te listes se hartuar nga Komisioni i Regjistrimit te E. K. A. dhe mban numrin:* 103, *sipas kesaj liste*

**SEKRETARI**

(JORGJI BOLLANO)

*Leshuar me,* 10.04.200

**PRESIDENTI**

(BAKI BERBERI)

PASAPORTE
PASSPORT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË / REPUBLIC OF ALBANIA



Tipi/Type
P

Kodi/Code
ALB

Nr.Pasaportës/Passport No.
Z1029107

Mbiemri/Surname
BAKALLI

Gjatësia/Height
172 CM

Emri/Name
HALIM

Gjinia/Sex
M

Shtetësia/Citizenship
ALB

Sytë/Colour of eyes
KAFE

Datëlindja/Date of birth
20 OCT/TETO 1962

Vendlindja/Place of birth
KUKES

Autoriteti lëshues/Authority
MFP

Nr.Personal/Personal No.
11011216805001

Data e lëshimit/Date of issue
19 MAY/MAJ 2004

Data e skadimit/Date of expiry
18 MAY/MAJ 2014

Firma e mbajtësit/Holder's signature

P<ALBBAKALLI<<HALIM<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<

Z1029107<1ALB6210205M1405185110112168050013 8

03 KORRIK 2006

# KERKESE

KERKUES : Besnik Bami, I biri I Aliut, I dtl. 27.04.1971, lindur ne Cudhi, Kruje dhe banues ne Fush-Kruje, shtetas shqiptar, madhore me zotesi të plote juridike per të vepruar, administrator i shoqerise " BAMI " shpk.

OBJEKTI : Depozitimin e vendimit nr. 2 date 28.06.2006 te Ortakut të vetem të shoqerise " BAMI " shpk.
Baza Ligjore : Ligji 7667 date 28.01.1993, ligji 7638 date 19.11.1992.

## PERPARA

## GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE

Me vendimin nr. 21891 date 02.09.1999 të Gjykates se Rrethit Tirane, eshte regjistruar shoqeria " BAMI " shpk. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, i zoteruar 100 % nga ortaku I vetem z. Besnik Bami.
Me vendimin nr. 2 date 28.06.2006, te Ortakut te Vetem te Shoqerise " BAMI " shpk, eshte vendosur:
Miratimi i raportit te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar, z. Halim Bakalli, per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise " BAMI " shpk.
Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise " BAMI " shpk, sipas menyres se percaktuar ne raportin e ekspertit kontabel te autorizuar, nga 100.000 leke ne vleren 15.600.000 leke, zmadhim i realizuar nepermjet kontributeve ne natyre te kontabilizuara ne bilanc dhe nga fitimet e rezervat e shoqerise gjendje te dates 31.12.2005.
- Depozitimin e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
Ne baze te ligjit 7667 date 28.01.1993 " Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe duhe respektuar per Shoqerite Tregtare ", kerkojme nga Gjykata e Rrethi Gjyqesor Tirane, qe te behet i mundur depozitimi i ketij vendimi, prane Zyres se Regjistrit Tregtar dhe nenvizimin e ndryshimeve perkatese ne skeden e shoqerise sipas ligjit.

ADMINISTRATOR

BESNIK BAMI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 2826 Rep .

## VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 28.06.2006, perpara meje noteres Elmira Kodra, u paraqit personalisht Besnik Bami, I biri I Aliut, I dtl. 27.04.1971, lindur ne Cudhi, Kruje dhe banues ne Fush-Kruje, shtetas shqiptar, madhore me zotesi të plote juridike per të vepruar, administrator i shoqerise " BAMI " shpk, mbajtes I pasaportes me nr. Z 1228093, i cili deklaroi se kerkesa e mesiperme eshte hartuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij të lire e të plote dhe e nenshkroi regullisht perpara meje noteres dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.



NOTERE

NOTERE
ELMIRA KODRA
RR. DURRESIT TIRANE
Tel. 04/ 238129

**VENDIM**
Nr.2 date 28.06.2006
**I ORTAKUT TË VETEM**
**TË SHOQERISE " BAMI " shpk**

Ne Seline e Shoqerise " BAMI " shpk u zhvillua mbledhja e Ortakut të Vetem të Shoqerise per të shqyrtuar raportin e paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar, per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise " BAMI " shpk, dhe ne perfundim,

**V E N D O S A**

Miratimin e raportit te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar, z. Halim Bakalli, per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise " BAMI " shpk.
Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise " BAMI " shpk, sipas menyres se percaktuar ne raportin e ekspertit kontabel te autorizuar, nga 100.000 leke ne vleren 15.600.000 leke, zmadhim i realizuar nepermjet kontributeve ne natyre te kontabilizuara ne bilanc dhe nga fitimet e rezervat e shoqerise gjendje te dates 31.12.2005.
- Depozitimin e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ngarkohet administratori i shoqerise z. Besnik Bami të ndjeke procedurat ligjore per depozitimin e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrit Tregtar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane.

**ORTAKU I VETEM**

Besnik BAMI
Besnik Bami

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
Nr. 2825 Rep.
Nr. 417 Kol

**VERTETIM**

Ne Tirane, sot me date 28.06. 2006, perpara meje noteres Elmira Kodra, u paraqit personalisht Besnik Bami, I biri I Aliut, I dtl. 27.04.1971, lindur ne Cudhi, Kruje dhe banues ne Fush-Kruje, shtetas shqiptar, madhore me zotesi të plote juridike per të vepruar, ortak i shoqerise " BAMI " shpk, mbajtes I pasaportes me nr. Z 1228093, i cili deklaroi se kerkesa e mesiperme eshte hartuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij të lire e të plote dhe e nenshkroi regullisht perpara meje noteres dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE
NOTERE
ELMIRA KODRA
RR. DURRESIT TIRANE
Tel. 04 238129

06 KORRIK 2006

# KERKESE

KERKUESI:
Besnik BAMI, i biri i Aliut, lindur ne Cudhi, Kruje, me 27.04.1971, banues ne Fushe Kruje, administrator i shoqerise "BAMI" sh.p.k.

OBJEKTI:
Depozitim te Vendimit nr.3 , date 29.06.2006 te Ortakut te vetem te shoqerise "BAMI" sh.p.k.

PERPARA:
Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane,

Me vendimin nr.21891 date 02.09.1999 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ndryshuar me disa vendime te tjera, eshte regjistruar si person juridik shoqeria "BAMI" sh.p.k., me Ortak te vetem z.Besnik BAMI.

Me vendimin Nr.3 date 29.06.2006, Ortaku i vetem i shoqerise "BAMI" sh.p.k., ka vendosur per ndryshimin e qendres se veprimtarise se shoqerise si dhe per shtese ne objektin e veprimtarise se kesaj shoqerie.

Ne baze te ligjit 7667 date 28.01.1993, "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar per Shoqerite Tregtare", kerkojme nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, qe te behet i mundur depozitimi i ketij vendimi, prane Zyres se Regjistrit tregtar dhe nenvizimin e ndryshimeve perkatese ne skeden e shoqerise sipas ligjit.

Per shoqerine "BAMI" sh.p.k.
ADMINISTRATORI
Besnik BAMI

REPUBLIKA E SHQIPERISE Import Export Ndërtim BAMI Shpk Besnik BAMI Lic 3607/2 F Krujë Albania

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA NOTEREVE TIRANE
Nr 2548 Rep

## VERTETIM

Sot, me date 29.06.2006, para meje noteres Elmira KODRA, u paraqit personalisht Zoti: Besnik BAMI, i biri i Aliut, lindur ne Cudhi, Kruje, me 27.04.1971, banues ne Fushe Kruje, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr.Z1228093, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "BAMI" sh.p.k., i cili me deklaroi, se jashte kesaj zyre, me vullnetin e tij te lire, ka perpiluar kerkesen e mesiperme, te cilen e firmosi para meje dhe une noteria e vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE ELMIRA XH. KODRA

NOTERE
Elmira KODRA

**"BAMI" sh.p.k.**
**Thumane, Shqiperi**

**VENDIM**
**Nr.3, date 29.06.2006**

Ne seline e shoqerise "BAMI" sh.p.k., u zhvillua mbledhja e Ortakut te Vetem te Shoqerise per te shqyrtuar disa kerkesa te administratorit te shoqerise lidhur me funksionimin me te mire te shoqerise "BAMI" sh.p.k., dhe ne perfundim,

VENDOSA :

1. Ndryshimin e qendres se veprimtarise se shoqerise nga adresa: Thumane, ne adresen Kameras-Fushe-Kruje,
2. Shtese ne objektin e veprimtarise, si me poshte:
   Prodhime dhe tregetime materiale ndertimi si inerte – gure; çakull, elemente betoni e beton arme te zakonshme, pararendur, gure dekorativ; prodhim elemente me baze bitumi sintetik. Ndertime civile, industriale, hekurudhore, turistike e bujqesore, rruge, ura dhe vepra arti, ujesjelles e kanalizime, impiante vaditjeje dhe te trajtimit te ujit, bankina, posena, portile, vaj sjelles-naftesjelles-gazsjelles, diga dhe dampa, silloza, kulla b/arme e metalike, themele te vecanta, izolime mbi dhe nen tokesore, punime karpentiere, instalim i ipmianeve ngritese dhe transportuese, termike-ventilim-kondicionim, i materjaleve prej druri-metalike, plastike dhe xhami, impianteve nen presion, per prodhimin e energjse nga burimet alternative, N/stacione, gabina te T.N e T.M, telefoni, radiofoni, televizive, citofoni etj.Pastrim dhe gjelberim, sinjalizim dhe ndricim te siperfaqeve urbane, punime topografike, topogjeodezike dhe speciale gjeodezike, punime bojatisje, hidroizolim, akustike, kundra zjarrit, termoizolim akustik.
   Punime ne projektim si : objekte civile, industriale, turistike e skelet betonarme, instalime termoteknike, ventilim, kondicionim, linja e rrjeta elektrike, furnizim me uje, kolektore shkarkimi, ujesjelles, kanalizime, vepra ujitje e te trajtimit te ujit, ura dhe vepra arti, gabina elektrike, rivelime.

-Depozitimin e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane,

Ngarkohet administratori i shoqerise z.Besnik BAMI te ndjeke procedurat ligjore per depozitimin e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ortaku i vetem

Besnik BAMI

Besnik Bami

REPUBLIKA E SHQIPERISE Import Export BAMI shpk Besnik BAMI Nderim Albania Lic 3607/2 F Kruje

05 QERSHOR 2006

KERKESE

KERKUESI:
Besnik BAMI, lindur ne Cudhi, Kruje, banues ne Fushe-Kruje, ortak i vetem i shoqerise "BAMI" sh.p.k. me seli ne Thumane.

OBJEKTI:
Regjistrimin e ndryshimeve ne aktet themeluese te shoqerise "BAMI" sh.p.k., ne mbeshtetje te ligjit Nr.7512, date 10.08.1991 dhe te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992,

PERPARA:
Gjykates se rrethit gjyqsor Tirane,

Une i nenshkruari Besnik BAMI, i paraqes asaj Gjykate kerkesen time te meposhteme:

Me vendimin Nr.1, date 29.05.2006, ne mbledhjen e ortakut te vetem te shoqerise "BAMI" sh.p.k. eshte miratuar vleresimi i kapitaleve te shoqerise "BAMI" sh.p.k. si dhe caktimi i ekspertit per kryerjen e ketij vleresimi.

Ne keto rrethana, me cilesine e administratorit te shoqerise "BAMI" sh.p.k. kerkoj regjistrimin e ndryshimeve te akteve themeluese ne regjistrin tregtar te shoqerive prane kesaj gjykate.

Bashkalidhur kerkeses ju paraqes:

1. Vendimin Nr.1, date 29.05.2006 te ortakut te vetem te shoqerise "BAMI" sh.p.k.
2. Licencen e ekspertit kontabel te autorizuar, i caktuar per kete vleresim.

"BAMI" sh.p.k.
ADMINISTRATORI
Besnik BAMI

Thumane, me 29.05.2006

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA NOTEREVE TIRANE
Nr 2235 Rep

VERTETIM

Sot, me date 29.05.2006, para meje noteres Elmira KODRA, u paraqit personalisht Zoti: Besnik BAMI, i biri i Aliut, lindur ne Cudhi, Kruje, me 27.04.1971, banues ne Fushe Kruje, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr.Z1228093, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "BAMI" sh.p.k., i cili me deklaroi, se jashte kesaj zyre, me vullnetin e tij te lire, ka perpiluar kerkesen e mesiperme, te cilen e firmosi para meje dhe une noteria e vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

NOTERE
Elmira KODRA

"BAMI" sh.p.k.
Thumane, SHQIPERI

VENDIM
Nr.1, date 29.05.2006

Ortaku i vetem i shoqerise "BAMI" sh.p.k., me seli ne Thumane, i mbledhur sot me date 29.05.2006, diskutoi kerkesen e ortakut te vetem te shoqerise Zotit Besnik BAMI, "Per vleresimin e kapitalit te shoqerise" dhe ne baze te statutit te shoqerise "BAMI" sh.p.k. dhe te neneve 60, 64 dhe 71 te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare",

VENDOSI:

1. Te beje vleresimin e rritjes së kapitalit te shoqerise "BAMI" sh.p.k.

2. Caktimin e zotit Halim BAKALLI, ekspert te vleresimit te kapitaleve te shoqerise "BAMI" sh.p.k.

ORTAKU I VETEM
i shoqerise "BAMI" sh.p.k.
Besnik BAMI
Besnik Bami

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr.2234.Rep
Nr.334...Kol

VERTETIM

Sot me date 29.05.2006, para meje noteres Elmira KODRA, u paraqit personalisht: Besnik BAMI, i biri i Aliut, lindur ne Cudhi, Kruje, me 27.04.1971, banues ne Fushe Kruje, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr.Z1228093, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "BAMI" sh.p.k., i cili me deklaroi, se sa siper eshte sipas vullnetit te tij, ndaj e nenshkruajti ate dhe une noteria e vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjes.

REPUBLIKA E SHQIPERISE ELMIRA XH. KODRA NOTER TIRANË

VULLE TAKSE 100 LEKE SHQIPERISE

NOTERE
Elmira KODRA

# INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR TE SHQIPERISE
# (IEKA)

# LICENSE

Kjo license i leshohet , Z. HALIM QAZIM BAKALLI

per te ushtruar profesionin e **EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR** .

Kjo License leshohet ne baze te listes se hartuar nga Komisioni i Regjistrimit te E. K. A. dhe mban numrin: 103, sipas kesaj liste.

**SEKRETARI**

(JORGJI BOLLANO)

Leshuar me, 10. 01. 2001

**PRESIDENTI**

(BAKI BERBERI)

Berberi

# KERKESE

**KERKUESI** : z. Besnik Bami I biri I Aliut dhe I Hatixhese , dtl 1971 lindur e banues ne Thumane, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine ortakut te vetem te shoqerise “BAMI” sh.p.k

**Objekti** : Depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimit nr 1, date 29.03.2004 te ortakut te vetem te shoqerise “BAMI” sh.p.k

## GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
## TIRANE

Me vendimin nr.21891, dt.02.09.1999 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare “BAMI” sh.p.k me ortak te vetem dhe administrator kerkuesin z. Besnik Bami, me kapital themeltar 100'000 leke,me seli ne Thumane, me object te veprimtarise; Tregtim mallrave industrilale, ushqimore, materiale ndertimi me pakice dhe shumice.Ndertime civile , industriale,turistike e bujqesore.Punime restaurimi, hidraulike e punime te shtresave te rrugeve. Transport mallra e pasagjer. Servis e lavazh per automjete. Import eksport.Me vendimin Nr.1, date 29.03.2004 eshte vendosur te behet nje shtese ne objektin e veprimtarise se shoqerise edhe per: Import –Eksport te makinerive e pjeseve te kembimit per to, tregtimin e lendes drusore dhe duraluminit, import eksportin e pjeseve mekanike dhe elektrike per hidrovoret dhe tregtimin e tyre; Ne hapjen e bar-bufeve e restoranteve; per shitblerjen e dhenien me qira te pasurive te tundshme e te patundshme, Agjensi komisionere. Agjensi udhetimesh turistike dhe oraganizimin e udhetimeve individuale e kolektive brenda e jashte vendit, sherbimet qe lidhen me udhetimet pushimet pritjen e turisteve e trajtimin e tyre ne njesite akomoduese me ushqim ne bar-restorante vizitat ne objektet historiko-kulturore dhe transportin me mjtete e veta ose te te treteve Ne fushen e tregtimit me pakice te karburanteve,vajrave lubrifikate e gazit.

Ne keto kushte kerkoj depozitimin e ketyre ndryshimeve prane regjistrit tregtar.

KERKUESI

Besnik Bami

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**NR.** 1048 **REP.**
**NR.** **KOL.**

**V E R T E T I M**

Sot me date 30 03.2004, u paraqit Besnik Bami madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "BAMI" sh.p.k, i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperm e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

**N O T E R I P U B L I K**

NOTER AFRODHITA BEBE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SHOQERIA TREGETARE "BAMI "sh.p.k.**

**V E N D I M**
**NR. 1, DATE 29.03.2004**

Sot ne mbledhjen e dates **29.03.2004**, ortaku i vetem i shoqerise " BAMI" sh.p.k. mori ne shqyrtim aktivitetin e shoqerise dhe ecurine e saj ne te ardhmen dhe ne perputhje me statutin dhe ligjin

**V E N D O S I :**

1. Te shtoje aktivitetin e shoqerise edhe per: Import –Eksport te makinerive e pjeseve te kembimit per to, tregtimin e lendes drusore dhe duraluminit, import eksportin e pjeseve mekanike dhe elektrike per hidrovoret dhe tregtimin e tyre; Ne hapjen e bar-bufeve e restoranteve; per shitblerjen e dhenien me qira te pasurive te tundshme e te patundshme, Agjensi komisionere. Agjensi udhetimesh turistike dhe oraganizimin e udhetimeve individuale e kolektive benda e jashte vendit, sherbimet qe lidhen me udhetimet pushimet pritjen e turisteve e trajtimin e tyre ne njesite akomoduese me ushqim ne bar-restorante vizitat ne objektet historiko-kulturore dhe transportin me mjtete e veta ose te te treteve Ne fushen e tregtimit me pakice te karburanteve,vajrave lubrifikate e gazit.
2. Depozitimin e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

O R T A K U
**Besnik Bami**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**NR.** 1049 **REP.**
**NR.** **KOL.**

**V E R T E T I M**

Sot me date 30.03.2004, u paraqit Besnik Bami madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "BAMI" sh.p.k, i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperm e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

**N O T E R I P U B L I K**

KERKUES:Besnik Bami,biri i Aliut,datelindje 1971,banues ne Thumane,me certifikate lindje Nr.20/31

OBJEKTI:Rregjistrimi si person juridik i shoqerise tregtare BAMI Sh.p.k. ne rregjistrim tregtar.

BAZA LIGJORE:Ligji 7667 date 29/01/1993 PER RREGJISTRIN TREGTARE.

GJYKATES SE RRETHIT

T i r a n e

Ju paraqesim kerkesen si me posht:

Kohet e fundit kam krijuar shoqerine tregtare BAMI Sh.p.k. me qender ne Thumane te Krujes,me kohezgjatje 25 vjet,me kapital themeltar 100.000 leke,dhe me objekt veprimtarie: Tregtim mallera industriale, ushqimore,materiale ndertimi me pakice dhe shumice.Ndertime civile, industriale,turistike,bujqesore.Punime restaurimi,hidraulike e punime te shtresave te rrugeve.Transport mallera e pasagjer.Servis e lavazh per automjete.Import eksport.

Per kete qellim,perveç depozitimit te kapitalit themeltar kam bere aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise qe jua paraqes.

Shpresoj se kerkesa do te me pranohet.

ORTAKU I VETEM,THEMELUES DHE ADMINISTRATOR I SHOQERISE TREGTARE * BAMI SHPK*

Besnik Bami

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA NOTERIALE KRUJE
NR.10682.REP.

VERTETIM

Sot,me date 01/09/1999,u paraqit para meje noterit Qazim Mani z.Besnik Bami identiteti i te cilit shenohet ne hyrje te kesaj kerkese, me zotesi per te vepruar,i cili,me vullnet te lire nenshkroi kete kerkes.

NOTERI

Qazim Manj

REPUBLIKA E SHQIPERISE QAZIM MANI NOTER KRUJE